



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY GJILAN  
FAKULTETI I EDUKIMIT  
Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjilan, Republika e Kosovës  
[www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net) tel. +381 (0) 280390112

---

Gjilan, më 26. 11.2018

### Manifestimi i UKZ për 28 Nëntor 2019

*Fjalimi i Rektorit prof. asoc. dr. Bajram Kosumi në ceremoninë e diplomimit të studentëve të gjeneratës së dytë të Universitetit Kadri Zeka në Gjilan*

Çdo ditë që del dielli, edhe atëherë kur nuk duket dielli, nga thellësia e zemrës sime i falënderoj të gjithë ata burra e ato gra, me emër e pa emër, që dhanë jetën, dijen dhe pasurinë për lirinë, për kombin tonë dhe për dy shtetet shqiptare.

Ky Flamur këtu, kjo gjuhë e bukur shqipe, kultura, letërsia, folklori dhe historia jonë na bëjnë unikë edhe kur jemi të ndarë.

Edhe ne që jemi sot këtu e kemi rastin historik të bëjmë diçka për lirinë dhe për shtetin tonë.

Festa e Flamurit është për të festuar, por më shumë se kaq është për të forcuar idealet tona për zhvillim e përparim.

Sot, profesori dhe studenti, kemi rastin më ideal historik për të bërë shumë për lirinë, për kombin dhe për shtetin tonë: ta ngritim e ta lartësojmë kombin tonë në komb të fuqishëm, të arsimuar, të pasur në mesin e kombeve të lira dhe në faktor të rëndësishëm të paqes në rajon e në botë.

Ju ftoj dhe ju uroj ta shfrytëzoni këtë rast historik!

Urime të gjithë shqiptarëve dhe miqve tanë Dita Flamurit!